

VENDIM
Nr.71, datë 4.2.2005

**PËR RRITJEN E MASËS SË TRAJTIMIT TË VEÇANTË TË PUNONJËSVE, QË
KANË PUNUAR NË DISA NDËRMARRJE TË INDUSTRISË USHTARAKE, DHE
TË PILOTËVE FLUTURUES, NË PENSION**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake, të nenit 5 të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për punonjësit, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake, masa e trajtimit të veçantë, e përfituar sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, rritet 8 për qind.
 2. Për pilotët fluturues, në pension, masa e trajtimit të veçantë, e përfituar sipas ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, rritet 8 për qind.
 3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.
 4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, Ministri i Financave dhe drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano